



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1616 Prot.
Tiranë, më 23/11 /2020



**AUTORITETI I MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

Nr. 3324 Prot.
Tiranë, më 23/11 /2020

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET:

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), si institucion i pavarur publik, i cili është ngritur dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010, përfaqësuar këtu nga Komisioneri z. Robert GAJDA,

dhe

Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), përfaqësuar nga Kryetari z. Gentian SALA,

që më poshtë u referohemi me termin “Palët”:

Palët, në zbatim të Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe në zbatim të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendosin lidhje institucionale, me qëllim promovimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, çuarjen përpara të bashkëpunimit të ndërsjelltë ndërmjet tyre, në realizimin e veprimtarisë në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi në këtë fushë.

Duke njohur rëndësinë e mbrojtjes dhe garantimin e mbrojtjes nga diskriminimi në fushën e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive;

Me qëllim rritjen e bashkëpunimit midis palëve në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, në fushën e mediave audiovizive në Republikën e Shqipërisë;

Palët e këtij Memorandumi Mirëkuptimi (më poshtë “*Memorandumi*”) bien dakord të bashkëpunojnë me qëllim të shkëmbimit të përvojës dhe informacionit si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti

Ky Memorandum ka për objekt institucionalizimin e bashkëpunimit dhe përcaktimin e rregullave dhe mënyrave brenda të cilave Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive, do të zhvillojë marrëdhëniet e tyre të bashkëpunimit të ndërsjelltë, në kuadër të punës së përbashkët për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, për çështje të interesit të përbashkët që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e mediave audio dhe/ose audiovizive, në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm si dhe interesat e ligjshme të qytetarëve shqiptarë.

Objekti i këtij Memorandumi mirëkuptimi është përcaktimi i fushave dhe i formave të tjera të bashkëpunimit ndërmjet palëve për çështje të interesit të përbashkët që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi në fushën e mediave audio dhe/ose audiovizive.

Neni 2

QËLLIMI

Ky Memorandum ka si qëllim realizimin e veprimtarisë së përbashkët në respektimin, forcimin dhe avancimin e mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë, të të drejtave që lidhen me mbrojtjen e grupeve të marginalizuara; rritja e bashkëpunimit në drejtim të forcimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi, të transparencës dhe të llogaridhënies; për të parandaluar dhe ndaluar rastet e veprimtarisë së paligjshme, si dhe për të kërkuar ndërhyrjen pozitive sa herë që është e nevojshme.

Neni 3

Angazhimi i paleve

1. Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për realizimin e detyrave të parashikuara në legjislacionin në fuqi, sipas fushës së kompetencave, bashkëpunim i cili do të fokusohet në sa më poshtë:

- a) shkëmbim ekspertize për përmirësimin e legjislacionit ekzistues sa herë që ndërthuren fushat e kompetencës;
- b) angazhimin e përbashkët për çështje të përmbajtjeve audiovizive duke pasur në fokus mbrojtjen nga diskriminimi në tregun e mediave audiovizive ;

- c) nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të përbashkëta që i shërbejnë mbrojtjes nga diskriminimi, garantimit të barazisë mbrojtjes të barabartë vecanërisht gjatë veprimtarisë së subjekteve audio/audiovizive;
- d) Shkëmbimin e informacionit dhe rekomandimeve për çështjet që lidhen me mbrojtjen nga diskriminimi;
- e) Bashkëpunimin në evidentimin e situatave problematike, referimin e rasteve konkrete dhe marrjen e masave përkatëse në rast konstatimi të shkelejeve ligjore.

2. Palët mund të ndryshojnë në çdo kohë fushën e bashkëpunimit, nëpërmjet ndryshimit të marrëveshjes.

3. Secila prej palëve do të emërojë nga një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit, sipas fushave të angazhimit që përcaktohen nga kjo marrëveshje.

Neni 4

Shkëmbimi i informacionit

1. AMA dhe KMD shkëmbejnë informacionin e nevojshëm, të cilin pala marrëse e ruan me të njëjtin nivel konfidencialiteti, si pala dërguese.
2. Shkëmbimi i informacioneve bëhet sipas përcaktimeve në ligjet respektive të mbrojtjes nga diskriminimi dhe të mediave audiovizive, Kodit të Procedurave Administrative dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në momentin e nënshkrimit të këtij memorandumi.
3. Angazhimi reciprok për hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore në fushat respektive të mbuluara nga palët.
4. Procesi i shkëmbimit të informacionit do të bazohet në parimin e besueshmërisë reciproke, transparencës mes palëve për atë që lejon legjislacioni në fuqi, efikasitetin në përshpejtimin e kohës së shkëmbimit të informacionit dhe vullnetin pozitiv për të vënë në dispozicion informacionin e disponueshëm konform legjislacionit.
5. Secila nga palët duhet të garantojë konfidencialitetin e marrë nga pala tjetër. Informacioni i marrë në kuadër të këtij Memorandumi nuk mund t'i transferohet një pale të tretë, pa pasur një autorizim me shkrim nga pala që ka siguruar informacionin.
- 6.

Neni 5

Grupet e përbashkëta të ekspertëve

Palët mund të ndërtojnë grupe të përbashkëta pune sipas ekspertëve, sipas nevojës, *ad-hoc*, për aspektet e analizës së situatës, procedurave të inspektimit apo bashkëpunimit ndërinstitucional

për çështje të karakterit të përbashkët, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Secila palë i mbart shpenzimet e veta lidhur me ekspertët e saj.

Neni 6

Organizimi i konferencave

Palët, kur është e përshtatshme, do të informojnë dhe do të ftojnë në workshope, seminare, simpoziume dhe konferenca kombëtare dhe/ose ndërkombëtare të organizuara nga palët, Komisioni Evropian etj., apo autoritetet simotra të vendeve të rajonit, BE e më gjerë.

Neni 7

Koherenca e takimeve mes palëve

Titullarët e palëve respektive do të takohen në rast nevojë për sa i përket implementimit të këtij Memorandumi, në mënyrë që të rendisin prioritetet e bashkëpunimit brenda kësaj kornize dhe vazhdimin e tij, shkëmbim pikëpamjesh dhe sipas mundësive, do të ndërmarrin veprime dhe pozicione të përbashkëta në forume dhe organizata evropiane ndërkombëtare, që kanë të bëjnë me sektorin e mediave audiovizive.

Neni 8

Analiza e zbatimit të Memorandumit

Palët do të shqyrtojnë në baza dyvjetore, rezultatet e bashkëpunimit të tyre, sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit. Palët do të ndërmarrin hapa për përmirësimin e bashkëpunimit dhe do të bëjnë propozime të përshtatshme për të ndryshuar fushën e veprimit të këtij Memorandumi të Mirëkuptimit.

Neni 9

Pikat e kontaktit

1. Në dhe për zbatim të kësaj marrëveshjeje, personat e kontaktit do të jenë:

a. Për KMD-në: Brunilda Menalla

Kontakt: Brunilda.Menalla@kmd.al

355 68 46 43 60

b. Për AMA-n: Urim Bajrami, Kryetar i Këshillit të Ankesave

Kontakt: urim.bajrami@ama.gov.al

355 67 200 1414

Neni 10

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Memorandumi hyn në fuqi në datën e poshtëshënuar dhe mund të ndërpritet nga secila palë, duke njoftuar palën tjetër paraprakisht në një afat kohor prej 1 (një) muaji.

U firmos dhe hyn në fuqi në datë 23.11.2020

PËR

**KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI**

KOMISIONERI
Robert GAJDA



PËR

**AUTORITETIN E MEDIAVE
AUDIOVIZIVE**

KRYETARI
Gentian SULA

